

Einwohnergemeinde
Herzogenbuchsee
Abteilung Bildung
Mittelholzstrasse 34
3360 Herzogenbuchsee
Tel. 062 961 57 06
bildungssekretariat@herzogenbuchsee.ch
www.herzogenbuchsee.ch

Sachbearbeiter/in	Telefon direkt	E-Mail	Datum
Karin Jaun/Franziska Hofer	062 961 57 06	bildungssekretariat@herzogenbuchsee.ch	22. Januar 2010

Orientim për prindërit

Të dashur prindër

Me këtë shkresë ju orientojmë për Përkujdesjen Shkollore të Dhëmbëve (Schulzahnpflege) në komunën tonë. Nën faqen e internetit www.herzogenbuchsee.ch/topic2943/story6068.html mund të shkarkohet Rregullorja e Përkujdesjes së Dhëmbëve e datës 1. Januar 2010, e cila shërben si bazë. Këtë mund ta gjeni edhe në Administratën e Komunës.

Kontrolli vjetor e të gjithë fëmijëve në kopsht dhe në shkollë është i obligueshëm. Ky kontroll shërben si masë profilaktike dhe njëherit mënjanon shumat e larta për trajtimin e dhëmbëve.

Para kontrollit

Kontrolli te një mjek apo mjek i dhëmbëve (Emrat dhe adresat shiko në faqen prapa) organizohet çdo vit nga instituti i Përkujdesjes së Dhëmbëve. Luteni ta shënoni në faqen 2-të të kartës së kaltër, se te cili mjek apo cila mjekë duhet të shkojë fëmija i juaj në kontroll. Kontrolli është falas. Nëse më me dëshirë e qoni fëmijën te një mjek privat i dhëmbëve, atëherë harxhimet duhet t'i merrni vetë përsipër.

Pas kontrollit

Mjeku i dhëmbëve e shënon gjendjen e dhëmbëve të fëmijës suaj në faqen e 4 -të të kartës së kaltër, e cila do t'ju dërgohet me anë të postës. Nëse ju deklaroheni se jeni të pajtimit atëherë edhe do të bëhet trajtimi i rekomanduar nga mjeku i dhëmbëve. Por ju duhet të kontaktoni vetë mjeken/un shkollor apo mjekun privat të dhëmbëve që të merreni vesh për një termin. Po qe se mjeku privat i dhëmbëve e bënë kontrollin ai duhet ta vërtetojë këtë me nënshkrimin dhe me vulën e tij në faqen 3-të të kartës së kaltër.

Pas trajtimit

Pas përfundimit të trajtimit nënshkruajeni kartën e kaltër në faqen e 3-të në kolonën e 5-të dhe dërgojani këtë më tutje Drejtorisë për Përkujdesjen e Dhëmbëve. Nëse fëmija i juaj është trajtuar nga mjeku apo mjekja shkollore e dhëmbëve, ai apo ajo, do ta dërgojë direkt kartën në Drejtorinë e Përkujdesjes së Dhëmbëve.

Mjekët shkollor të dhëmbëve janë të obliguar ta bëjnë trajtimin me tarifa të volitshme. Shpenzimet e trajtimit duhet të paguhet nga prindërit. Familjet me të ardhura të pamjaftueshme kanë të drejtën e pjesëmarrjes së komunës në këto shpenzime. Këto ndihma do të plotësohen sipas shpenzimeve neto ,

kjo do të thotë pasi të hiqen pagesat e shpenzuesve të tjerë (sigurimi shëndetësor, sigurimet etj). Ndalesa (Selbstbehalt) prej 100 frangave do të jetë gjithsesi një detyrim i familjes. Për këtë arsye kërkesat për shpenzimet e trajtimit mund të bëhen vetëm nëse ato janë nga 150 franga e më shumë. Formularët e kërkesës do të dërgohen së bashku me kartën e dhëmbëve. Ato i gjeni në Drejtori për Përkujdesjen e Dhëmbëve apo te Shërbimi Social.

Në raste të korrigjimit të dhëmbëve mund t' u jepen ndihma nga institucioni Përkujdesja e Dhëmbëve, nëse plotësohen disa parakushte të caktuara,. Këshillohuni për këtë me mjekun e dhëmbëve.

Për pyetjet eventuale është Drejtorja për Përkujdesjen e Dhëmbëve në dispozicionin tuaj.

Me përshëndetje shoqërore

GEMEINDEVERWALTUNG HERZOGENBUCHSEE

Abteilung Bildung

Sekretariat/Schulzahnpflege:

Karin Jaun

Adresat

Sekretaria Shkollore
SZP-Drejtoresha
Karin Jaun
Mittelholzstrasse 34
3360 Herzogenbuchsee
Tel. 062 961 57 06

Dr. W. Aeschbacher
Wangenstrasse 10

Tel. 062 961 64 14

Dr. B. Stampfli
Bahnhofstrasse 14

Tel. 062 961 19 66

Dr. M. Rüegg
Oberstrasse 28

Tel. 062 961 11 11

Dr. B. Christen
Unterstrasse 4

Tel. 062 961 59 61

Dr. B. Nikitovic
Cuno-Amiet-Str. 7

Tel. 062 961 67 91 Tel.

Dr. M. Nygren
Lagerstrasse 14

062 961 99 90